



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR

**Këshilli
Konsultativ**



Procesverbali i Mbledhjes

**Këshilli Konsultativ mes Qeverisë Qendrore dhe Qeverisë Vendore
Mbledhja e datës 17 dhjetor 2025**

Tabela e Përmbajtjes

Hapja e mbledhjes.....	1
1.Projektvendimi ““Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar””.....	2
2.Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës se shpërblimit te drejte për huadhënien publike”	4
3.Projektvendimi “Për miratimin e normave, standardeve, çmimet bazë dhe praktikat më të mira në fushën e pyjeve”.....	6
4.Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve”.....	8
5.Projektvendimi “Për rishikimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030”,.....	9
Shtojcë: Të pranishëm	10

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të VKM nr. 244, datë 17.4.2024 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjes Vendore”, më datë 17 dhjetor 2025 u zhvillua mbledhja e Këshillit Konsultativ te Pallati i Kongreseve, Salla e Albanologjisë. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Konsultativ, përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe donatorë të huaj.

Mbledhja u kryesua nga Z. Ervin Demo, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, i cili përshëndeti ministrat pjesëmarrës, si dhe falënderoi shoqatat dhe përfaqësuesit e NJVV-ve.

PROJEKTAKTE TË KONSULTUARA

1. Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar”

Znj. Gentiana Troplini, Përgjegjës Sektori, Agjensia Kombëtare e Bregdetit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit prezantoi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 649, datë 16.10.2024, Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar”.

Znj. Troplini theksoi se akti referohet për ndryshim si pasojë e dy kërkesave;

- ecurisë së sezonit turistik veror 2025;
- kërkesës nga NJVV-ve për ndërhyrje në këtë proces i cili i referohet shtimit të një tipologjie të re të plazhit për tarifimin dhe administrimin e sipërfaqeve të caktuara të plazheve e cila do të inkuadrohet në hartën të plazheve.

Plazhet e reja të administruara nga bashkitë do t’u japin këtyre mundësinë të ofrojnë çadra në dispozicion të pushuesve. Kjo tipologji e re nuk çënon plazhet publike dhe nuk prek raportin që çdo 1000 m linear, 300 m të jenë në dispozicion të publikut.

Znj. Troplini përmendi ndryshimet e parashikuara për sezonin turistik veror 2026 si vijon;

- Ri-emërtimi i disa ministrave për efekt të përbërjes së Komitetit të Menaxhimit të Sezonit Turistik;
- Bashkëpunimi ndërinstitutional mes Njësive Vendore, Agjencive Rajonale të Bregdetit, Drejtorisë së Përgjithshme Detare dhe Policisë Kufitare, në funksion të procesit të përcaktimit të vendqëndrimeve dhe korridorëve hyrëse dhe dalëse;
- Shtimin e tipologjisë së “Plazheve publike të tarifuar nga NJVV-të”, të cilat më pas do të pasqyrohen dhe në hartën e plazheve të propozuar nga secila NJVV-re;
- Ripërcaktimin e hapësirës nga vija e bregut të detit, për plazhet e tipit A, duke hequr hapësirën prej 2.5 (dy pikë pesë) m, por pa prekur distancën të paktën 10 m nga vija e bregut të detit;

- Lejimi i subjekteve për të aplikuar për struktura shërbimi të tipologjisë “beach bar”, sipas një projekt modeli standard të propozuar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe që miratohet nga Këshilli Kombëtar i Territorit;
- Rritja e monitorimit të nivelit të zhurmave të lejuara në zonën breg-ujore;
- Përfshirja e më shumë bashkive, zonave përjashtimore që nuk kanë struktura akomoduese pranë apo në afërsi të hapësirës së plazhit, por kanë nevojë për të ushtruar veprimtarinë si stacion plazhi.

Konkretisht:

- Përjashtimisht, për bashkinë Fier, bashkinë Divjakë, bashkinë Pogradec, për plazhin Zvërnec, Plazhi i Vjetër, bashkia Vlorë, plazhet Spille, Vil-Bashtovë, bashkia Rrogozhinë, Plazhet Shetaj, plazhi i Gjirit të Lalzit, plazhi Hamallaj, plazhi Katundit të Ri, plazhi Porto Romano1, plazhi Currila1, plazhi Currila 2, plazhi Currila 3, plazhi Currila 4, plazhi Currila 5, bashkia Durrës, plazhet Borsh, Llaman, Plazhi Lukovë 2, bashkia Himarë, në stacionet e plazhit, që nuk ka struktura akomoduese pranë apo në afërsi të hapësirës së plazhit, nuk zbatohet kriteri i parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 7, dhe subjekti, përveç kriterëve të parashikuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 3, të nenit 7, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme;
- të disponojë një strukturë shërbimi dhe të ketë hapësirë plazhi pranë strukturës së shërbimit.

Efektet që parashikohen të sjellë akti janë:

- Rritje të të ardhurave për disa njësi të vetëqeverisjes vendore, krahasuar me sezonin turistik veror 2025, pasi në plazhe specifike, në të cilat nuk ka prani të strukturave akomoduese, do të mundësohet aplikimi në sistemin e-Albania edhe për subjektet që disponojnë struktura shërbimi;
- Përmirësimin e standardeve në sezonet e ardhshme turistike, referuar:
- monitorimit të nivelit të zhurmave;
- lëvizjes së mjeteve lundruese turistike;
- afateve në shqyrtimin e aplikimeve, për përmbylljen në kohë të proceseve të punës.
- Realizimin e Dixhitalimit të plotë të aplikimeve për stacion plazhi, duke përfshirë në aplikimin on-line në sistemin e-Albania, të gjitha plazhet në zonën bregujore (11 Bashki), e cila është e aksesueshme nga qytetarë, subjekte apo çdo institucion i interesuar.
- Rritja e bashkëpunimit institucional nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe institucioneve të tjera të angazhuara në mbarëvajtjen e sezonit turistik;
- Ofrimin e mundësisë për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit edhe në disa plazhe, në të cilat nuk ka prani të strukturave akomoduese.

Znj. Troplini theksoi se parashikimi është formuluar sipas kërkesave të njësisë të vetëqeverisjes vendore që vijnë si rezultat i mungesës së strukturave akomoduese në këto zona/plazhe. Në mënyrë që të mos cënohet veprimtaria e subjekteve që operojnë prej vitesh në këto plazhe, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, vlerësojnë se këto plazhe, duhet të kenë rregullim të veçantë, njësoj si përjashtimet aktuale të VKM-së, konkretisht për Bashkitë Fier e Divjakë. Aplikimin e një modeli të unifikuar për llojin e strukturave të shërbimit (beach bar) që mund të vedosen në stacionin e plazhit, sipas një modeli të zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Komente:

Z. Pervin Gjikuria, Sekretar i Përgjithshëm, bashkia Himarë shtroi diskutimin mbi pjesën e plazhit të Lukovës, Borshit dhe Lllamanit të cilat sjellin të ardhura rreth 500 mijë euro për bashkinë Himarë, por mos harrojmë dhe koston e mirëmbajtjes së këtyre plazheve, sidomos Lukova dhe Lllamani nuk mundet që pushuesit të marrin shërbime, ndaj kërkojmë përjashtimin e këtyre plazheve nga kriteri i përcaktuar në projektvendim.

Znj. Troplini theksoi se e kanë përfshirë kërkesën e tyre, por me miratimin e titullarëve do kalojë dhe në institucion.

Z. Demo sqaroi se ka qenë në ndjekje të këtij akti me ministrinë e turizmit dhe ka patur takime me kryetarët e bashkive, të cilët preken nga ky akt dhe besoj që përjashtimi i zonave të përmendura të Himarës është një proces i këtij konsultimi.

2. Projektvendimi “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së shpërblimit të drejtë për huadhënien publike”

Znj. Borana Ajazi, Drejtor, Drejtoria e së Drejtës së Autorit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit prezantoi projektvendimin “Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së shpërblimit të drejtë për huadhënien publike”, e cila shpjegoi se kur jepet një produkt i autorit për huadhënie publike për një qëllim të caktuar, përjashtuar qëllimet ekonomike, autori ka të drejtë të shpërblehet për këtë si një e drejtë që citohet nga Ligji “Për të drejtën e autorit”. Pra, çdo përdorim i kufizuar ose jo kërkohej të shpërblehet mbajtësi i të drejtave.

Projektvendimi ka qëllim:

- shpërblimin e autorëve të veprave letrare dhe veprave muzikore në formën e fletës së pentagramit, si njohje e humbjes së të ardhurave që vjen nga vënia në dispozicion e veprave të tyre për huadhënie ose përdorim në bibliotekat publike në Shqipëri;
- të mbështesë pasurimin e kulturës shqiptare duke inkurajuar krijimin e veprave letrare dhe veprave muzikore në formën e partiturës muzikore (pentagram);
- garantimin e shpërblimit të mbajtësit të të drejtave të autorit dhe dhënia shtysë për krijimin e veprave të tjera të cilat janë pjesë e huadhënies publike.

Shpërblimi është i detyrueshëm për huadhëniet e kryera nga të gjitha bibliotekat publike, me përjashtim të huadhënies të kryera nga institucionet arsimore, universitare ose të kërkimit shkencor, si dhe nga bibliotekat e referencës, bibliotekat për personat përfitues sipas Traktatit të Marrakeshit, siç janë persona me aftësi të kufizuar në lexim apo shikim.

Veprat e kualifikuara për shpërblim nga e drejta e huadhënies publike janë librat e botuar, librat audio, librat në formë elektronike dhe partiturat muzikore. Termi “Libër” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për librin në Republikën e Shqipërisë dhe në numrin ndërkombëtar të standardizuar të librit (ISBN).

- Kjo nuk përfshin:
- një libër që nuk është ofruar për shitje për publikun;
- një botim si: gazeta, revista, buletine, botimin e përditshëm dhe periodik;
- librat e botuar nga organizatat jofitimprurëse;
- tekstet shkollore të destinuara për përdorim në shkollë;
- grafikët, hartat, planet dhe tabelat.

Librat duhet të kenë të paktën 36 faqe, përveç librave për fëmijë, për të cilët nuk ka kufizime. Librat e kualifikuar nuk mund të kenë më shumë se 3 autorë. Redaktorët, autorët e parathënies dhe të teksteve hyrëse nuk përfshihen në rregullat e shpërblimit.

Librat audio trajtohen në të njëjtën mënyrë si librat e tjerë dhe duhet të jenë të botuar në format fizik (CD) ose shkarkim digjital (MP3) brenda pesë viteve të fundit me një kod ISBN 13-shifror të regjistruar.

Libri në formë elektronike duhet të jetë i publikuar ose i botuar brenda pesë viteve të fundit me një kod ISBN 13-shifror të regjistruar. Shuma e shpërblimit të drejtë rregullohet çdo 3 (tre) vjet.

Kriteret për përcaktimin dhe rregullimin e kësaj shume janë si më poshtë:

- objektivat e promovimit kulturor;
- numri total i bibliotekave;
- financimi i tyre vjetor;
- numri total i vëllimeve në koleksionet e tyre;
- numri total i huadhënies;
- praktikat ndërkombëtare të tregtisë, të përshtatura me kushtet e Republikës së Shqipërisë duke pasur parasysh popullsinë dhe produktin e brendshëm bruto.

E drejta për shpërblim për huadhënien publike ushtrohet përmes administrimit kolektiv të detyrueshëm (AAK-ve). Sporteli unik kryen funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit të huadhënies publike për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, të mbrojtura nga të gjitha agjencitë e administrimit kolektiv të licencuara.

Shpërblimi për huadhënien publike paguhet në baza vjetore. Shpërndarja e të ardhurave të mbajtësit e të drejtave bazohet në statistikat e huadhënies publike nga institucionet që mbulohet shpërblimi.

Shpërblimi për huadhënien publike të veprave letrare shpërndahet për shkrimtarët, përkthyesit, fotografët, ilustruesit dhe krijuesit e veprave të artit pamor.

Agjencia e administrimit kolektiv përcakton rregulla në lidhje me metodologjinë e shpërndarjes së shpërblimeve për qëllim të huadhënies publike, në zbatim të Ligjit “Për të drejtën e autorit”.

Agjencitë e administrimit kolektiv për hartimin e metodologjisë për shpërndarjen e të ardhurave për qëllime të huadhënies publike bazohen në numrin e veprave, numrin e faqeve, llojin e veprës dhe për veprat me bashkautorë në bazë të kontributit. AAK-të mund të vendosin vlera fikse për shpërndarjet.

Roli i Bibliotekave Publike dhe Qeverisja Vendore;

Bibliotekat publike, si institucionet që ofrojnë huadhënie pa pagesë, janë hallka kryesore e zbatimit.

Përgjegjësia e NJVV-re qendron në mbështetjen dhe koordinimin e bibliotekave në detyrimin për dhënien e informacionit, statistikave për Sportelin unik.

Efektet e aktit janë si vijon:

- Sigurimi i të ardhurave të qëndrueshme për autorët;
- Nxitja e krijimit të veprave me rëndësi kulturore dhe shoqërore;
- Përmirësimi i qasjes së publikut në librat dhe artin kombëtar;
- Forcimi i rolit të bibliotekave publike si qendra të njohurisë dhe kulturës;
- Rritja e kapaciteteve të qeverisjes vendore për monitorimin dhe administrimin e shërbimeve publike;
- Harmonizon praktikën vendase me standardet ndërkombëtare dhe përgatit Shqipërinë për anëtarësimin në BE.

Komente:

Nuk ka

3. Projektvendimi “Për miratimin e normave, standardeve, çmimet bazë dhe praktikat më të mira në fushën e pyjeve”

Znj. Elda Xhumari, Zëvendësministër, Ministria e Mjedisit prezantoi hyrjen e aktit “Për miratimin e normave, standardeve, çmimet bazë dhe praktikat më të mira në fushën e pyjeve”, duke cituar se; projektvendimi synon miratimin e normave, standardeve teknike, çmimeve dhe kategorive për njësi të punimeve sipas operacioneve që kryhen në pyje dhe kullota, me qëllim rritjen e efikasitetit të punës, mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, harmonizimin e praktikave me standardet kombëtare, përafrimin dhe harmonizimin e tyre me praktikat ndërkombëtare, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, rritjen e efikasitetit të punës, mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit.

Aspekt i rëndësishëm në fondin e pyjeve dhe kullotave janë punimet e ndryshme që duhen kryer bazuar në praktikat më të mira të përcaktuara nga planet e mbarështimit që lidhem me përmirësimin e këtyre burimeve. Në aspektin teknik, realizimi i këtyre operacioneve standarde dhe çmimeve bazë të punës llogaritet sipas nivelit të vështirësive me indeksin e koeficientit të çmimeve që do të realizohen nëpërmjet fondeve buxhetore me donacione të ndryshme, të kryhen në mënyrë të unifikuar në të gjithë vendin nga çdo person fizik ose juridik. Akti i mundëson bashkive mirëadministrim, rehabilitim dhe shtim të vlerave të këtyre. Akti vendos norma dhe çmime bazë për llojet e punimeve që do kryehen, si dhe normalizon dhe standardizon tregun e punës.

Znj. Xhumari i kaloi fjalën z. *Ylli Hoxha, Përgjegjës Sektori, Ministria e Mjedisit* për sqarime teknike të aktit.

Z. Hoxha shtoi që shtojcat janë ato që tregojnë normat bazë për njësi çmimet bazë për secilin punim që kryhet në fondin pyjor. Ka patur një libër normash që nga viti 1945 nga Ministria e Bujqësisë të huazuar dhe të mbajtur në këto shtojca, të cilin e kemi përditësuar me ndikimet mbi pagën minimale dhe me ndryshimin e pagës minimale ndryshon dhe referenca për njësi. Projektvendimi nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit. Ministria e Drejtësisë ka sjellë komente për aktin, të cilat do i reflektojmë në versionin final të aktit me disa shtesa dhe nënpika.

Komente;

Z. Jaupllari sqaroi se pyjet dhe kullotat duhet ti kalojnë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me azhurnimet pëkatëse duhet ti kalojnë ministrisë përkatëse. *Z. Jaupllari* shtroi pyetjen nëse këto punime private përfshihen në këto norma duke parë që gjysma e pyjeve dhe kullotave janë punime fotovoltaike.

Z. Hoxha sqaroi se çdo punim me fonde shtetërore apo donacione nga vendas apo të huaj i nënshtrohen kostove përkatëse në shtojcat e projektvendimit.

4. Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve”

Znj Elda Xhumari, Zëvendësministër, Ministria e Mjedisit prezantoi hyrjen e aktit “Për miratimin e Planit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve”, duke theksuar që parandalimi i krijimit të mbetjeve përbën një objektiv strategjik kombëtar. Ligji “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” përcakton qartë hierarkinë e mbetjeve me synim parandalimin e krijimit të mbetjeve. Sistemi i menaxhimit të mbetjeve është i fokusuar drejt asgjësimit, ndërkohë që potenciali për riciklim, parandalim, mbetet i pa shfrytëzuar ende. Plani kombëtar i parandalimit të mbetjeve

përbën një element politik dhe operacional, i cili synon të vendos parandalimin në qendër të vendimmarrjes publike nga një qasje reaguese në qasje parandaluese. Plani ka një kuadër të unifikuar masash për jetën e ciklit të produkteve nga projektimi dhe prodhimi, te konsumi, deri në fund të jetës së ciklit. Masat sigurojnë reduktimin e mbetjeve në burim, zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve si dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme të konsumit. Prioritet mbeten mbetjet organike, mbetjet plastike, ambalazhet dhe mbetjet nga ndërtimet. Zbatimi i programit do ulë sasinë e mbetjeve që gjenerohen dhe dërgohen për asgjësim, si dhe do krijojë bazë bashkëpunimi ndërinstitutional.

Znj. Elvana Ramaj, Drejtor në Drejtorinë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, sqaroi se akti del në zbatim të pikës 4, të nenit 66 të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Projektvendimi miraton dokumentin e Programit Kombëtar për Parandalimin e Krijimit të Mbetjeve në përputhje me Direktivën Kuadër të Mbetjeve (2008/98/KE), të ndryshuar. Parandalimi i krijimit të mbetjeve është në krye të hierarkisë së mbetjeve.

Objektivi kryesor është;

- promovimi i parandalimit të mbetjeve si një mjet për të shkëputur rritjen ekonomike nga gjenerimi i mbetjeve dhe për të përshpejtuar tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie qarkulluese më efikase në përdorimin e burimeve;
- krijimin e një mjedisi të favorshëm për sektorin e biznesit për të zbatuar praktika të parandalimit të mbetjeve dhe ekonomisë qarkulluese;
- promovimin e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm.

Programi Kombëtar i Parandalimit të Krijimit të Mbetjeve, si pjesë përbërëse e projektvendimit përbëhet nga 8 kapituj që kanë në përmbajtje kryesisht vendosjen e kërkesave dhe masave për parandalimin e krijimit të mbetjeve në Shqipëri si më poshtë;

Kapitulli I, prezanton qëllimin dhe rëndësinë e PKPM në kontekstin kombëtar dhe Europian, duke theksuar se parandalimi i mbetjeve është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në hierarkinë e menaxhimit të mbetjeve, që kontribon në reduktimin e ndikimeve mjedisore, uljen e kostove të menaxhimit dhe mbështetjen e zhvillimit të një ekonomie qarkulluese;

Kapitulli II, analizon trendin e gjenerimit të mbetjeve në nivel kombëtar vitet e fundit, përbërjen e mbetjeve dhe sektorët që kontribuojnë më shumë. Kjo krijon bazën për identifikimin e fushave ku ndërhyrjet e programit janë më të nevojshme dhe me efekt më të madh.

Kapitulli III, trajton objektivat e PKPM-së dhe përcakton objektivat strategjike të tij:

- forcimin e kuadrit rregullator;
- nxitjen e konsumit dhe prodhimit të qëndrueshëm;
- përmirësimin e zbatimit të masave parandaluese;
- orientimin drejt ekonomisë qarkulluese;
- përcaktohen objektivat për rritjen e ripërdorimit, zvogëlimin e mbetjeve bio dhe minimizimin e përdorimit të produkteve, veçanërisht plastikës.

Kapitulli IV, paraqet Zonat Potenciale të Ndërhyrjes:

- identifikohen fushat me ndikim në parandalimin e mbetjeve;
- ndërhyrjet në kuadrin rregullator për parandalimin e krijimit të mbetjeve;
- përmirësimi i projektimit dhe prodhimit për parandalimin e krijimit të mbetjeve, dhe
- promovimi i konsumit të qëndrueshem dhe zgjatja e jetëgjatësisë së produktit.

Kapitulli V, përmban 3 fusha prioritare e të programit 47 masa për parandalimin e krijimit të mbetjeve, që synojnë:

- forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për parandalimin e mbetjeve;
- mundësimin e praktikave të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit;
- adresojnë rrymat prioritare të mbetjeve, si plastika, ambalazhet, mbetjet organike dhe ato nga ndërtimi e shembja.

Kapitulli VI, paraqet treguesit e arritjes dhe treguesit e rezultateve dhe masave të identifikuara që do të përdoren për të matur progresin.

Masat që lidhen me parandalimin e mbetjeve në sektorin e prodhimit dhe të industrisë, do të synojnë:

- optimizimin e proceseve operative, uljen e sasive të mbetjeve, si dhe përmirësimin e tregut me produkte;
- rezistente në kohë, të riparueshme dhe të ripërdorshme.

Kapitulli VII, siguron fleksibilitet dhe adaptueshmëri të Programit për periudhën 2026 – 2030 dhe përmban:

- Metodologjinë e monitorimit;
- Parimet për vlerësimin e zbatimit të programit;
- Mekanizmat për mbledhjen e të dhënave;
- Mënyrën e rishikimit të programit.

Kapitulli VIII, paraqet Planin e Veprimit, që përmban një listë të detajuar të masave që do të zbatohen në periudhën 2026 - 2030, institucionet përgjegjëse, afatet kohore, burimet e nevojshme dhe ndikimin e pritshëm të secilës masë.

Plani i Veprimit përbën pjesën operacionale të programit duke e bërë atë të zbatueshëm në praktikë. Pjesë e PKPM është dhe Shtojca që përmbledh të gjitha veprimet e parashikuara në program, të shoqëruara me ndikimin e tyre në parandalimin e krijimit të mbetjeve. Kjo ndihmon në qartësimin e masave dhe në monitorimin e efektivitetit të tyre.

Komente:

Nuk ka

5. Projektvendimi “Për rishikimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-2030”

Znj, Ketj Gjinali, Sektori i Përgatitjes dhe Fizibilitetit të Projekteve në Fushën Industrisë dhe Energjisë, prezantoi projektvendimin “Për Rishikimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020-230” duke cituar se; Shqipëria po zbaton Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën

(PKEK) 2020–2030 për të përmbushur objektivat kombëtare dhe rajonale të dekarbonizimit. PKEK iu është nënshtruar rishikimeve të mëtejshme për t’u harmonizuar me rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (EnCS) për përmirësimin e PKEK-së, dhe për të ju përshtatur objektivat e reja deri në vitin 2040. PKEK i jep rol të drejtpërdrejtë bashkive, duke përfshirë planet e tyre të energjisë dhe klimës në hartimin e politikave kombëtare.

Roli i bashkive është:

- ulja e emëttimeve të GES në nivel vendor përmes integritit të burimeve të rinovueshme të energjisë në ndërtesat publike;
- përmirësimi i efikasitetit të energjisë përmes rinovimit të ndërtesave, ndriçimit efikas dhe menaxhimit të konsumit të energjisë;
- zhvillimin e tregut të brendshëm të energjisë përmes nxitjes së vetëprodhuesve dhe krijimit komuniteteve energjetike;
- forcimi i sigurisë së furnizimit përmes uljes së kërkesës për konsum të energjisë dhe diversifikimit të prodhimit të saj;
- nxitja e kërkimit, inovacionit dhe digjitalizimit përmes zhvillimit të sistemeve të matjes, monitorimit dhe raportimit të të dhënave;

Fushat kryesore të përgjegjësiave për bashkitë janë si vijon ku përfshihen;

Ndërtesat publike;

- administrimi dhe rinovimi energjetik i shkollave, kopshteve, spitaleve dhe objekteve administrative;
- aplikimi i masave të efikasitetit të energjisë dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme në nivel lokal.

Transporti urban dhe mobiliteti;

- Planifikimi dhe menaxhimi i transportit publik;
- Reduktimi i emëttimeve përmes planeve të mobilitetit urban të qëndrueshëm;
- Elektrifikimi gradual i flotave bashkiake.

Ndriçimi publik;

- Zëvendësimi i teknologjive joefikase me ndriçim LED;
- Zbatimi i sistemeve inteligjente për menaxhimin e energjisë.

Menaxhimi i mbetjeve;

- ulja e emëttimeve përmes ndarjes në burim, riciklimit dhe trajtimit të qëndrueshëm të mbetjeve;
- Kontribut në ekonominë qarkulluese dhe objektivat e dekarbonizimit.

Operacinet në nivel vendor janë;

- përshtatja dhe përditësimi i MECAP, planeve të zhvillimit vendor dhe planeve të mobilitetit urban në përputhje me objektivat kombëtare të energjisë dhe klimës;
- zbatimi i masave të efikasitetit të energjisë dhe përdorimi i burimeve të rinovueshme në ndërtesat publike dhe ndriçimin publik;
- përfshirja e objektivat të dekarbonizimit dhe efikasitetit të energjisë në vendimmarrjet për zhvillimin urban;
- mbledhja dhe raportimi periodik i të dhënave mbi konsumin e energjisë dhe zbatimin e masave, në përputhje me kërkesat kombëtare;
- bashkëpunim i vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe pjesëmarrje aktive në mekanizmat e koordinimit për zbatimin e PKEK.

Znj. Gjinali theksoi se shumë bashki kanë nisur nga hartimi i planeve vendore.

Komente:

Z. Jaupllari shtoi se zbatimi i aktit afekton bashkitë dhe kërkohet bashkëpunim ndërinstitucional. Z. Demo shtoi se me agjendën e Bashkimit Evropian për mbylljen e kapitujve në vitin 2027 shumë institucione nuk janë në dijeni për sasisë e implementimit të nismave ligjore, ku 65 % e tyre gjejnë implementim në NJVV-re. Politikat e institucioneve qëndrore dhe buxhetet për bashkitë duhet të mbështeten sipas nevojave të tyre për implementim të suksesshëm të akteve, të cilat përkthehen në territor. Z. Demo theksoi se qeveria do ju vijë në ndihmë bashkive për këto nisma ligjore, për këtë periudhë sfiduese duke ndryshuar qasje proaktive të bashkive në mënyrën se si do përthithin fondet.

Z. Demo falenderoi dhe uroi pjesëmarrësit për vitin 2025, një vit frutdhënës i bashkëpunimit institucional dhe uroi ministrat, kryetarët e bashkive dhe donatorët për vitin 2026, duke theksuar që mbledhjet do i alternojmë me mbledhje online dhe plenare çdo muaj.

Shtojca 1: Të pranishëm në mbledhje

Anëtarët e Këshillit Konsultativ			
Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni	Institucioni/Organizata
1	Ervin Demo	Ministër Shteti për Pushtetin Vendor	Kryeministria
2	Elona Hoxha	Zv/ministër	Ministria e Drejtësisë
3	Enkelejd Musabelliu	Zv/ministër	Ministria e Ekonomisë, dhe Inovacionit
4	Elda Xhumari	Zv/ministër	Ministria e Mjedisit
5	Arian Jaupllari	Zv/ministër	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
6	Oriana Osmani	Zv/ministër	Ministria e Arsimit
7	Ermira Urupi	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Elbasan
8	Ervis Moçka	Kryetar	SHKQSH, Këshilli i Qarkut Vlorë

Shënim: Materialet e diskutuara në mbledhjen e datës 17 dhjetor 2025 mund t'i gjeni në linkun e mëposhtëm;

<https://qeverisjaveendore.gov.al/keshlli-konsultativ/mbledhjet-e-keshillit-konsultativ/viti-2025/17-dhjetor-2025/>

Sekretariati Teknik i Këshillit Konsultativ E-mail: keshilli.konsultativ@amvv.gov.al Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark, ish- Shtëpia e Oficerave, Kati i VII", Tiranë, Shqipëri.